




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale neni 37, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit Nr. 05/L-042, neni 6 paragrafi 2.2, Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) merr:


VENDIM

Për emërtimin e zyrtarit përgjegjës për mbrojtje të të dhënave personale.

1. Emërohet znj. Flora Hajrizi zyrtare përgjegjëse për mbrojtje të të dhënave personale.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtares:
 - 2.1 Informon dhe këshillon kontrolluesin ose përpunuesin dhe të punësuarit, të cilët kryejnë përpunimin mbi detyrimet e tyre në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e të dhënave.
 - 2.2 Jep këshilla sipas rastit, në lidhje me vlerësimin e ndikimit mbi mbrojtjen e të dhënave dhe monitoron performancën në pajtim me nenin 35 të Ligjit në fjalë.
 - 2.3 Bashkëpunon me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, si dhe vepron si pikë kontakti për Agjencinë duke përfshirë konsultimin paraprak.
 - 2.4 Zyrtarja për mbrojtjen e të dhënave, në përmbushje të detyrave të saj, merr parasysh si duhet rrezikun që shoqëron veprimet e përpunimit, duke marrë parasysh natyrën, objektin, kontekstin dhe qëllimet e përpunimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi datën e nënshkrimit

Vendimi i dorëzohet:

- Znj. Flora Hajrizi
- Arkivës së ARRU-së


Raif Preteni
Drejtor i ARRU